



AGISEE
Shoqata e Informacionit Gjeohapsinor per Europen Juglindore
<http://www.agisee.org>

Shoqata fton anetare te rinj

Njoftim Shtypi

Shoqata per Informacionin Gjeohapsinor ne Europen Juglindore, AGISEE, eshte krijuar me 1 tetor 2004, ne Sofie te Bullgarise, si nje organizate **jo-fitimpruse**.

Nevoja per krijimin e saj lindi si rezultat i projektit GISEE (Teknologjia dhe Tregu i GIS-it ne vendet e Europes Juglindore), i cili studjoi dhe dokumentoi gjendjen e infrastruktures se te dhenave hapsinore ne te gjitha vendet e Europes Juglindore. GISEE u financua nga Komisioni European dhe perfundoi ne tetor te vitit 2003 me konferencen **Infrastruktura e te dhenave hapsinore ne Europen Juglindore**, zhvilluar ne Sofie te Bullgarise, ku u ra dakort per krijimin e kesaj shoqate.

Infrastruktura e te dhenave hapsinore (SDI), ka per qellim pergatitjen e te dhenave gjeohapsinore per t'i bere ato te vlefshme per kerkesat e ekonomise dhe te shoqerise. SDI nderthur politikat, aspektet organizative, te dhenat, teknologjite, standartet, mekanizmat shperndares si dhe burimet financiare e njerezore te nevojshme per te garantuar qe ata qe punojne ne shkalle globale e rajonale, nuk do hasin veshtiresi ne arritjen e objektivave te tyre. Informacioni Gjeohapsinor eshte nje informacion mbi formen dhe vendodhjen e objekteve ne sipërfaqen e Tokes. Shembuj te informacioneve te tille jane hartat topografike, imazhet satelitore te tokes, hartat kadastrale dhe regjistrat e pronesise, hartat e qyteteve e shume te tjera.

Projekti GISEE deshmoi per ekzistencen e mjaft te dhenave gjeohapsinore ne Europen Juglindore. Megjithate, shfrytezimi i tye paraqet mjaft veshtiresi, sepse si zoteruesit ashtu edhe kushtet e shfrytezimit te tyre nuk jane te qarta. Shfrytezimi i te dhenave do te lehtesohej shume me ane te te ashtuquajturave meta data, qe s'jane gje tjetër veçse pershkrime te te dhenave reale. Por per fat te keq ekzistojne shume pak te dhena te tilla. Organizatat nuk bashkepunojne, dhe pak aktivite jane organizuar per fuqizimin e ketij sektori. Me kete duam te themi se sektori i Informacionit Gjeohapsinor nuk eshte zhvilluar e organizuar mire ne kete rajon. Kjo shtron domosdoshmerine e nje koordinimi dhe bashkepunimi me te mire ne kete sektor, qe ne fakt eshte dhe objektivi kryesor i Shoqates.

Nismetaret e AGISEE-s jane Prof. Dr. Raina Pavlova nga Universiteti Teknik i Sofies, njekohesisht koordinator e GISEE, si dhe Ulrich Boes, drejtor i URSIT Shpk., gjithashtu pjesemarres ne projektin GISEE. Ulrich Boes eshte zgjedhur ne postin e Presidentit te Shoqates, kurse Raina Pavlova eshte zgjedhur anetare e Bordit Drejtues te Shoqates, se bashku me Georgi Valev (Bullgari), pedagog i gjeodezise ne Universitetin e Arkitektures, Inxhinierise se Ndertimit dhe Gjeodezise ne Sofie, Miljenko Lapaine (Kroaci), pedagog i gjeodezise ne Universitetin e Zagrebit dhe President i Shoqates Kroate te Hartografise, Rahmi Celik (Turqi), pedagog ne Universitetin Teknik te Stambollit, Florian Petresku (Rumani), pedagog ne Universitetin Teknik te Bukureshtit, dhe Evgenia Karadjova (Bullgari), administratore e pergjithshme e ESRI-t ne Bullgari.

AGISEE eshte shoqata e vetme e informacionit gjeohapsinor ne tere rajonin e Europes Juglindore. Ajo i referohet vendeve si Shqiperia, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia, Rumania, Serbia e Mali i Zi, Kosova dhe Turqia. Vizioni i AGISEE-s eshte krijimi i infrastruktures se te dhenave hapsinore ne rajon dhe te mundesoje shfrytezimin e ketyre te

dhenave ne dobi te zhvillimit ekonomik te te gjithë vendeve pjesemarrëse ne te. Roli i shoqates do jete i dyfishte: se pari te informoje anetaret e saj per arrijtet e fundit ne kete fushe, si zhvillimi i teknologjise, standartet, shembujt e sukseseshem te perdorimit te GI, aktoret mbare-boterore, iniciativat Europiane, mjedisin ligjor ne vendet anetare apo jashte tyre, mundesite per te siguruar financime; se dyti ne promovimin e rolit te GI-se ne boten e jashtme dhe sigurimin e mbeshtetjes per nje perdorim sa me te mire te te dhenave hapsinore.

Per te arritur synimin e saj afatgjate, AGISEE ka percaktuar kater detyra kryesore:

1. te bashkoje komunitetin e GI-se si dhe te gjithë palet e interesuara nga Europa Juglindore.
2. te promovojë perdorimin e GI-se dhe te kontribuojë ne ndertimin e SDI ne rajon.
3. te perfaqesojë sektorin e GI-se ne vendet e Europes Juglindore e jashte tyre.
4. te mbeshtese e te furnizojë me informacionin perkates, si dhe te krijojë mundesi te reja per anetaret e saj.

AGISEE do te jete nje pike kontakti per anetaret e saj dhe komunitetin e GI-se. Seminaret dhe konferencat do te perbejne forumet per takime dhe diskutime. Konferenca e pare e AGISEE-s eshte planifikuar ne vjeshten e vitit 2005, dhe do te kete per qellim te shkembeje ide dhe te jape rekomandime per veprime te metejshme persa i perket ndertimit te Infrastruktures se te Dhenave Hapsinore ne Europen Juglindore. Duke filluar nga viti 2006, Shoqata do te organizojë dhe drejtojë kurse, workshope dhe seminare me qellim mesimdhenie.

Ftesa per antaresim eshte e hapur dhe individet e organizatat e interesuara mund te regjistrohen per antaresim ne adresen tone te Web-it <http://www.agisee.org>. Deri ne fund te vitit 2004, antaresimi do te jete falas. Ne fillim te vitit 2005, anetaret duhet te paguajne ne baze te kategorise se ciles i takojne. Pagesa do t'ju jape atyre mundesi te mira perfitimi. Nder keto mund te permendim:

- marrjen e informacionit per zhvillimet teknologjike, standartet, rastet efektive te perdorimit te GI-se, iniciativat europiane, mjedisin ligjor ne vendet anetare apo jashte tyre;
- vendosjen e nje pike te vazhdueshme kontakti e perfaqesimi kundrejt subjekteve te tjera si per shembull qeverite;
- pervesimi i perdorimit te standarteve dhe te teknologjise se re;
- shfrytezimi i te dhenave ne Web-site te pasur me informacion, gazeta, materiale te sapobotuara, libra;
- pjesemarrja ne kurse mesimdhenie, seminare e konferenca;
- konsulence per çeshtje te veçanta, per shembull perdorimi i standarteve ose i ligjeve perkatese;
- informim mbi mundesite e biznesit dhe programet e financuar nga Bashkimi European dhe vende te tjera;
- mbajtja e kontakteve me te gjithë anetaret e tjere.

AGISEE mbeshtetet nga shume organizata dhe individe ne Europen Juglindore. Kjo eshte shprehje e deshires se mire te ketyre vendeve per te qene me prane Bashkimit Evropian. Per me shume informacion vizitoni faqen e internetit te AGISEE ne adresen: <http://www.agisee.org>.